

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**, Kolegji për të mitur i përbërë nga gjyqtarët Have Haliti, kryetare e kolegjit, Hashim Çollaku dhe Gani Zabeli, anëtarë me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Eroll Gashi, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarit H.Z., nga Prishtina, për shkak të veprës penale, Dhunimi nga neni 193 par.2, nën par.1 lidhur me par.1 të KPK-së, duke vendosur sipas ankesës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë, të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për të mitur, PM.nr.295/2016 të datës 03.04.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 17.08.2018, mori këtë:

### A K T G J Y K I M

**Refuzohet** si e pa bazuar ankesa e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për të mitur, PM.nr.295/2016 të datës 03.04.2018, **vërtetohet**.

### A r s y e t i m

Me aktgjykimin e ankimuar të Gjykatës Themelore në Prishtinë -Departamenti për të mitur, PM.nr.295/2016 të datës 03.04.2018, i akuzuari H.Z., për shkak të veprës penale Dhunimi nga neni 193 par.2, nën par.1 lidhur me par.1 të KPK-së, është liruar nga akuza, pasi që nuk është provuar se i njëjti e ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë.

E dëmtuara Q.M. nuk ka parashtruar kërkesë pasurore juridike.

Shpenzimet e procedurës penale mbesin në ngarkesë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

Kundër këtij aktgjykimi, në afat ligjor ka ushtruar ankesë Prokuroria Themelore në Prishtinë, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, duke propozuar që ankesa e ushtruar të aprovohet si e bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar të anulohet, dhe çështja penale ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe vendosje.

Prokuroria e Apelit në Prishtinë me shkresën PPAM/I.Nr.75/2018, të datës 18.07.2018, duke u sqaruar përkitazi me ankesën e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, ka propozuar që e njëjta të aprovohet si e bazuar.

Gjykata e Apelit në kuptim të nenit 394 të KPPK, ka vlerësuar pretendimet ankimore nga ankesa e prokurorisë, propozimit me shkrim të Prokurorisë së Apelit në Prishtinë, si dhe shkresave tjera të lëndës, ka gjetur se:

**Ankesa Prokurorisë Themelore në Prishtinë, nuk është e bazuar.**

Me qenë se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është ankimuar për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, gjykata duke vepruar në pajtim me

nenin 394 të KPPK, e shqyrtoj aktgjykimin e ankimuar nëse i njëjti është marrë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, dhe gjeti se i njëjti nuk përmban shkelje të dispozitave të procedurës penale, të cilat do të kushtëzonin anulimin e tij, për të cilat shkelje kjo gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Po ashtu, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është ankimuar për shkak të shkeljeve të ligjit penal, mirëpo, kolegji i kësaj gjykate të njëjtin e ka shqyrtuar sipas detyrës zyrtare, dhe ka ardhur në përfundim se i njëjti nuk përfshihet me shkeljet e ligjit penal të parapara në kuptim të nenit 385 të KPPK, se vepra penale për të cilën është akuzuar i akuzuari parashihet me ligjin e aplikueshëm, se ekzistojnë rrethana që përjashtojnë të akuzuarin nga përgjegjësia penale dhe ndjekja penale, se gjykata në mënyrë të drejtë ka zbatuar ligjin i cili është i aplikueshëm në kohën e kryerjes së veprës penale, se gjykata ka vepruar në kuadër të kompetencës ligjore, andaj, aktgjykimi i ankimuar është i pranueshëm për kolegjin e kësaj gjykate.

Sipas ankesës së prokurorisë, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është ankimuar për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, duke theksuar se gjykata, e ka vërtetuar gabimisht gjendjen faktike për shkak se në asnjë rast dhe prej askujt, as të pandehurit H.Z., e as nga viktima Q.M., apo edhe vetë dëshmitarëve, nuk është mohuar ekzistenca e aktit seksual në mes të pandehurit dhe të dëmtuarës. E dëmtuara ka deklaruar se i pandehuri duke e vërejtur gjendjen jo të mirë materiale të saj, i kishte premtuar se do t'ia punësonte të vëllain me rrogë mujore deri në 1400 euro, si dhe do t'ia rregullonte shtëpinë, e në këtë rast jo vetëm se është kryes i veprës penale, por njëkohësisht me ato premtime është edhe shtytës i subjektit pasiv - viktimës, që ajo të kryejë aktin seksual me kryesin. Më tutje në ankesë theksohet se, rrethanat dhe shkaqet të cilat gjykata i ka marrë parasysh dhe e ka liruar të pandehurin nga aktakuza, prokurori konsideron se janë të pa bazuara, dhe nga kjo rrjedh se gjykata nuk e ka vlerësuar dhe vërtetuar drejtë gjendjen faktike të çështjes konkrete penale, e në anën tjetër, gjykata nuk e mori parasysh faktin se personat nën moshën 18 (tetëmbëdhjetë) vjeçare duhet të gëzojnë mbrojtje të posaçme penalo-juridike, sidomos në sferën e marrëdhënieve seksuale, pasi që ato mund të shkaktojnë pasoja të dëmshme për zhvillimin fizik dhe psikik të personalitetit të tyre, andaj, propozon që Gjykata e Apelit ta aprovoj këtë ankesë dhe çështjen t'ia kthej gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe vendosje.

Kolegji i kësaj gjykate ka vlerësuar ankesën e prokurorisë, aktgjykimin e ankimuar si dhe shkresat e tjera të lëndës, dhe ka ardhur në përfundim se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të plotë ka vërtetuar gjendjen faktike, kur të akuzuarin H.Z. e ka liruar nga akuza për shkak të veprës penale të dhunimit nga neni 193 par.2, nën par.1 lidhur me par.1 të KPK-së, ngase me të gjitha provat e administruara në shqyrtim gjyqësor sikurse janë, dëshmia e të dëmtuarës-e mitura Q.M., dëshmia e dëshmitarit V.M., dëshmia e dëshmitares M.Z., të dhëna si në polici e po ashtu edhe në shqyrtimin kryesor të mbajtur me datë 19.09.2017, vërtetojnë se i akuzuari H. nuk është kryes i veprës penale e cila i vihet në barrë. Nga shkresat e lëndës, në procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor të mbajtur me datë 19.09.2017, e dëmtuara-e mitura, Q.M. ka deklaruar se ka kryer marrëdhënie seksuale me të akuzuarin H.Z., me vetë dëshirë dhe se nuk dëshiron që i njëjti të ndiqet penalisht, dhe për shkak të presionit nga babai i saj ka qenë e detyruar që të shkoj në polici dhe ta paraqes rastin, pa vullnetin e saj të plotë, pasi ka qenë e frikësuar nga i njëjti, babai i saj. Gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur kur i ka falur besimin dëshmitares-të miturës Q.M., për shkak se për të ekzistuar vepra penale e dhunimit, patjetër duhet të ekzistoj mospëlqimi i subjektit pasiv-viktimës për akt seksual ose për ta vazhduar atë, dhe se viktima duhet ta bëjë të qartë dhe në mënyrë serioze se nuk ka vullnet për akt seksual dhe mospëlqimi duhet të

jetë i vazhdueshëm deri në momentin e fundit, e që në rastin konkret nuk ka elemente të tilla të cilat do ta bënin përgjegjës të akuzuarin H. për këtë vepër penale. Gjithashtu, gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur kur deklaratës së të akuzuarit H., ia ka falur besimin, pasi që i njëjti në detaje ka përshkruar rastin se si është takuar me të dëmtuarën, se si e njëjta e ka thirrur në telefon dhe ka kërkuar nga ai që të kenë marrëdhënie seksuale, se si ka dalë me të dëmtuarën, se me të njëjtën kanë qenë në një hotel në lagjen “Velania”, dhe në bodrumin e këtij hoteli në dhomën nr.3 me dëshirën e të dyve kanë kryer marrëdhënie seksuale pa presion, se takimet e të njëjtëve kanë zgjatur rreth 1(një) muaj dhe gjatë asaj kohe kanë kryer marrëdhënie seksuale në motelin “...”, deklaratë e cila përputhet edhe me deklaratën e të dëmtuarës- e mitura Q.M.. Gjukata e shkallës së parë drejtë ka vepruar, po ashtu, kur i ka falur besimin deklaratës së dëshmitares M.Z. e cila nuk ka dhënë asnjë deklaratë e cila do të qonte në dyshimin se i akuzuari H. e ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë, e po ashtu, edhe në deklaratën e dhënë në polici me datën 08.05.2018, ka deklaruar se pasi e ka kuptuar se babai i saj kishte marrëdhënie seksuale me të dëmtuarën-të miturën Q., i kishte thënë që mos të dilte me babanë e saj më, pasi që ai ishte i martuar dhe i kishte 8 fëmijë, mirëpo e dëmtuara - e mitura Q., i kishte thënë se nuk i intereson pasi që, ajo e donte të akuzuarin H., dhe se nuk dëshironte që të bisedojë për këtë punë. E pranueshme për Gjykatën e Apelit, është edhe deklarata e dëshmitarit V.M., të cilës ia ka falur besimin gjykata e shkallës së parë, ku i njëjti në seancën e shqyrtimit gjyqësor të mbajtur me datë 19.09.2017, deklaroi se nuk ka ndodhur asgjë, dhe se ndoshta motra e tij vetë ka pasur dëshirë që të dalë me të akuzuarin, se i njëjti është takuar me të akuzuarin H., pasi motra e tij Q. kishte qëndruar tre ditë në banesën e tij dhe i njëjti ka shkuar që ta marrë për ta dërguar në shtëpi, pasi që e ka kuptuar vendndodhjen e saj, deklaratë kjo e cila në asnjë mënyrë nuk qon në ndonjë dyshim, se i akuzuari ka kryer marrëdhënie seksuale pa dëshirën e të dëmtuarës- të miturës Q.M., andaj, konsiderojmë se gjykata e shkallës së parë pranë një gjendje të këtillë faktike, drejtë ka vendosur kur të akuzuarin H.Z., e ka liruar nga akuza, pasi që nuk është vërtetuar se i njëjti e ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë, dhe se me asnjë provë të vetme nuk është vërtetuar se i njëjti ka pasur marrëdhënie seksuale pa dëshirën e të dëmtuarës, apo që i njëjti ka ushtruar dhunë, apo e ka kërcënuar që të kryej marrëdhënie me të dëmtuarën, andaj, aktgjykimi i ankimuar si i tillë, është i pranueshëm dhe i drejtë edhe për kolegjin e kësaj gjykate.

Nga sa u tha më lartë e në pajtim me dispozitën e nenit 401 të KPPK, u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**  
**PAKR.nr.334/2018, më dt.17.08.2018**

**Bashkëpunëtori profesional**  
**Eroll Gashi**

**Anëtarët e kolegjit**  
**Hashim Çollaku**

**Kryetare e kolegjit**  
**Have Haliti**

**Gani Zabeli**